



## **Prioritetet e Këshillave Lokal**

### **Projekti: “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë”**

Organizata joqeveritare Syri i Vizionit nga Peja, në kuadër të projektit “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë” ka mbajtur takime me kryetarët e këshillave lokal në gjashtë (6) komuna ku ky projekt shtrihet: Rahovec, Gjakovë, Deçan, Klinë, Istog dhe Pejë.

Qëllimi i këtyre takimeve me kryetarët e këshillave lokal ishte radhitja e prioriteteve, tri (3) deri në pesë (5) me të rëndësishmeve për lokalitetin e tyre, në mënyrë që komunat në investimet e tyre kapitale dhe planifikimet buxhetore për vitin 2023 t’i përfshijnë këto prioritete duke ndikuar në përmirësimin e drejtpërdrejtë të kushteve të jetesës dhe mirëqenien e banorëve dhe rritur transparencën e investimet me përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve.

Duhet theksuar se në takimin me kryetarët e këshillave lokal nuk kanë marrë pjesë të gjithë kryetarët, pavarësisht ftesave të dërguara me kohë dhe mundësisë së ofruar që prioritetet e tyre t’i adresojnë tek ne edhe me shkrim.

Prioritetet e dala nga takimi me kryetarët e këshillave lokal në komunën e Pejës janë si më poshtë:

## **Prioritetet e këshillave lokal të dala nga pjesëmarrësit në takim**

### **Këshilli lokal Drelaj**

1. Riparimi dhe rregullimi i rrugës magjistrale nga Patrikana deri tek Piramidat në Kuqishtë
2. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza në të gjitha fshatrat
3. Shtrimi i sistemit të ujësjellësit në të gjitha fshatrat
4. Menaxhimi i mbeturinave, sidomos atyre përgjatë rrugës kryesore
5. Asfaltimi i rrugës nga Shtupeqi i Vogël deri në Llaz e Bellopaq
6. Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat tjera si Pepiq, Leqinat dhe Qafa e Dasmorëve.

### **Kryshec**

1. Ndërtimi i impiantit për ujërat e zeza
2. Ndërtimi i kanalit për ujitjen e tokave përbuzë rrugës Ahmet Gashi - diku rreth 600 metra
3. Rregullimi i ndriçimit publik në fshat
4. Asfaltimi i rrugës 2000 metra në lagjen “Muharrem Bajrami” diku 800 metra; “Lagjen Gërvalla” 800 metra; “Lagjen e Dautve” 205 metra; “Lagjen Driton Berisha” 20 metra; “Sylë Dervishi” 30 metra; “Dinë dhe Xhevdet Gashi” 20 metra; “Ismet Meta” 40 metra dhe “Selmon Berisha” 50 metra
5. Rregullimi i një pjesë të qendrës së fshatit dhe kubëzimi nga qendra deri tek shkolla e fshatit
6. Riparimi i prerjeve të asfaltit nga operatorë të ndryshëm.

### **Raushiq**

1. Asfaltimi i rrugëve që lidhin Raushiqin me Pejë - diku 500 metra. Rruga “Te Liridoni”, Raushiq-Loxhë diku 600 metra dhe Raushiq-Zllapek 1500 metra
2. Kanalizimi i ujërave të zeza, Lagja e Boqollve - diku 1000 metra
3. Zgjerimi i rrugës kryesore prej udhëkryqit të Raushiqit - diku 900 metra
4. Trotuaret prej udhëkryqit të shkolla, Qendër, deri tek “Lagja Dinaj” - diku 2 kilometra
5. Kanalet e ujitjes në rrugën “Kanali i Lugut”, te presa numër 9, Lagja Morina deri tek Ademajt
6. Rruga “Lagja Gjekaj” dhe “Shkreli” 1500 metra, e cila lidhet me shkollë dhe qendër të fshatit.

### **Kristal**

1. Rrjeti i kanalizimit në lagjet kryesore. Shkolla “Smajl Hajdari”, “Lagja Nick”, “Beleg” dhe “Lagja Isuf Lajqi”

2. Ndriçimi i rrugës “Ramush Lajqi” dhe “Fatos Ademaj” dhe rrugës anësore “Azem Syla”
3. Asfaltimi i rrugicave, diku 2 kilometra, në kuadër të “Lagjes Kristal”
4. Ndërtimi i çerdhes për fëmijë.

## **7 Shtatori**

1. Hapja e e kanaleve për ujëra të zeza dhe kyçja e tyre në rrjetin kryesore në Lagjen “Fidanishte” dhe lagjen “7 Shtatori”
2. Riparimi i kanalit për ujëra të zeza në rrugën “Hamdi Berisha” dhe afër transitit
3. Ndriçimi publik në rrugën “Azem Lukaj” dhe atë “Agim Çelaj”
4. Mirëmbajtja e ndriçimit publik
5. Trajtimi i mbeturinave, furnizimi me shporta familjare në rrugën “Xhevdet Hoti”, “Kurt Abazi” dhe “Ploja e Fierzës”
6. Asfaltimi i rrugës nga shtëpia e Besim Ukës e cila vazhdohet me Brestovik
7. Ndërtimi i lifteve në objektet e vjetra në Fidanishte

## **Dardani I**

1. Vendosja e pasqyrave të sigurisë për kyçje në rrugën kryesore
2. Riparimi i rrugës nga prerjet
3. Pastrimi i mbeturinave në rrugën “UÇK” dhe “Ardian Krasniqi”
4. Kanalizimi i ujërave të zeza mbi “Rrethi Ukaj”, rruga “UÇK”, ku 80 shtëpi duhet kyçen në rrjetin kryesor
5. Rruga “Ardian Krasniqi” nga marketi “Portokalli”, riparimi i pusetave ose rregullimi i gjithë rrugës.

## **Nabërgjan**

1. Asfaltimi i rrugëve rrugicave apo anekseve në “Lagjen Iberdemaj”, 300 metra; “Shpëtim Kuqi”, “Halit Bërbati”, 300 metra; “Te Xhamia”, familja Daci - diku 300 metra; “Mahalla e Nushit” 300 metra; “Lagja Belkaj” po ashtu 300 metra; “Familja Berisha” 400 metra; Tek Varrezat dhe “Lagja Bajraktari: po ashtu nga 300 metra.
2. Ndriçimi publik në “Mahallen e Nushit”
3. Vazhdimi i kanaleve të ujitjes në lagjet e fshatit Belkaj dhe Nushi.

## **Sahatkulla**

1. Kanalizimi i ujërave të zeza prej restoran “Era” e teposhtë për familjet të cilat jetojnë në atë lagje të re – “Maja e Zezë”
2. Eliminimi i derdhjes së ujërave të zeza në kanal in e hapur “Çokolica”.

## **Karagaq**

1. Pastrimi i kanalit për ujëra të zeza dhe atmosferike, apo ndërtimi i një kanali të ri diku 100 metra në lagjen “Edit Durham”, pasi që kanali ekzistues është dëmtuar dhe gjatë reshjeve vërshon
2. Ndërtimi i urës që lidh pjesën e lagjes “Taphone” me atë Tabakëve dhe shkollën “8 Marsi”
3. Investime në identifikimin, hapjen dhe rregullimin e shtigjeve të reja në park.

### **Xhemail Kada**

1. Kanalizimi në rrugën “Via Egnatia” – diku 1500 metra. Rruga e shkollës e cila lidhet me rrugën kryesore
2. Mbulimi i kanalit të hapur nga “Furra Husaj” në drejtim në shkollës “Xhemail Kada”, deri mbi shkollë
3. Në rrugët “Vëllezërit Topulli” dhe “Shtjefën Gjeçovi” duhet të bëhet riparimi i kanalizimit duke rritur hapësirën e gypave pasi që ai ekzistues nuk është funksional dhe nuk e përballon volumin. Ka një gjatësi prej 180 metrash
4. Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën “Shpëtim Bojku” në drejtim të restorantit “Horizonti”
5. Rrëzimi i objekteve të vjetra të ndërtimet sociale, ish garazhi i Kosovatrans-it
6. Ndërtimi i çerdhes publike në hapësirat e objektit të ish-teknikës, apo ri-destinimi i këtij objekti për çerdhe.

### **Cigë**

1. Ndërtimi i rrugës Brestovik -Lipë e Vogël
2. Asfaltimi i rrugës që lidh Lipen me Ishtedimin
3. Ndërtimi i ujësjellësit për Lipë, Brestovik dhe Ishtedim
4. Ndërtimi i kanaleve për ujitje të tokave në Cigë dhe Brestovik si dhe ndërtimi i kanalit të ujitjes në “Lagjen Bërdynaj”.

### **Ozdrim dhe Dubovë**

1. Vazhdimi i ndriçimit në lagjet e fshatrave Dubovë dhe Ozdrim
2. Trotuari nga shkolla “Sami Frashëri” deri te Elshanët dhe deri të sheshi i Dubovës
3. Asfaltimi i të gjitha rrugëve – diku rreth 250 metra
4. Ndërtimi i kanalit të ujit të ujitjes nga Ura deri në hyrje të fshatit Ozdrim
5. Rrethimi i tokës në fshatin Ozdrim.

### **Qendra**

1. Ndriçimi i rrugës “Halil Agusholli”
2. Vendosija e policëve të shtrirë në rrugën “Ardhmëria” deri tek “Ahmet Gjokolli” dhe “Isa Demaj”.

## **2 Korriku**

1. Ndriçimi publik në rrugën “Asllan Çeshmja” 10 trupa, “Kapiten Rudi” dhe “Beteja e Albulenës”, rruga “Fet Ukella” - diku 7 shtylla
2. Asfaltimi i rrugës, kanalizimi dhe ujësjellësi në rrugën “Azem Bejta” dhe zgjerimi i rrugës e trotuareve në rrugët “Mbreti Bardhyl”, “Azem Bejta” dhe “Asllan Çeshme”
3. Mirëmbajtja e policëve të shtrirë dhe rivendosja në rrugën “Mbreti Bardhyl”
4. Të bëhet pastrimi i “Çokolicës” dhe eliminimi i derdhjes së ujërave të zeza dhe mbulimi i kanalit
5. Të lirohen parcelat publike (Te Barakat) dhe ndërtohet terreni sportiv - basket dhe futboll
6. Vendosja e anësoreve mbajtëse te ura e shkollës “Asdreni”, dy shtylla ndriçuese dhe pengesa te Ura e Çokolices, Rruga “Ali Pashë Tepelena”
7. Vazhdimi i murit mbrojtës rruga “Tahir Coli” dhe largimi i murit në rrugën “Mbreti Bardhyl” dhe “Sylë Tabaku”.

Ky dokument është hartuar në kuadër të programit “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë” i cili zbatohet nga Syri i Vizionit, Communication For Social Development, EC Ma Ndryshe dhe Democracy Plus që kanë lidhur aleancë për zbatim të këtij programi i cili mbështetet financiarisht nga Olof Palme International Center.

**Komuna: Pejë, shtator 2022**